



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

EKSTRAKT

Nga procesverbali i mbledhjes së 17-të të KKSB-së mbajtur, më 08.03.2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 14,⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Fauz Xhemajli, nenkryetar i Komunës,
2. Valdet Morina, Stacioni Policor në Lipjan
3. Armend Bikliqi, FSK,
4. Zaim Baftiu, BIK, anëtar
5. Nazim Gashi, anëtar, drejtor i DMSH-së, Lipjan
6. Haqif Rrustemi, kryesues i EVSB Lipjan
7. Fehmi Gajtani, KLSP, anëtar
8. Alush Bikliqi, anëtar,
9. Ana Guciq, Komuniteti kroat, anëtare
10. Milazim Sadiku, anëtar
11. Bekim Krasniqi, OJQ "YAHK" anëtar
12. Muhamet Qeriqi, OJQ "POLIS" anëtar
13. Hasan Luma, anëtar
14. Brahim Duriqi, anëtar
15. Fatmir Goliqi, ZLK

Të tjerë prezent

1. Besart Troshupa, zyrtar për informim
2. Bestar Ibrahim, zyrtar i teknologjisë
3. Naser Bytyqi, përkthyes, shqip-serbisht
4. Merita Bytyqi, përkthyes serbisht shqip

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**

Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës, i përshëndeti të pranishmit, tha më vjen mirë që të gjithë jeni mirë. Në vitin e kaluar kemi mbajte 6 takime dhe pse ka qenë vit me pandemi, por ne prapë kemi vazhdu me takime të rregullta.

Pastaj tha se rendin e ditës e keni marrë, a ka dikush vërejtje apo plotësime. Dhe në vazhdim e lexoi rendin e ditës.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktin nga takimi i kaluar.
2. Diskutimi dhe aprovimi i Raportit të punës së KKSBB për vitin 2020
3. Diskutimi,plotësimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSBB për vitin 2021.
4. Raport për gjendjen e sigurisë në teritorin e komunës së Lipjanit (PK, DMSH).
5. Të ndryshme.

Pasataj pyeti se a ka vërejtje apo plotësime.

Me që nuk pati vërejtje as plotësime u aprovua rendi i ditës së propozuar.

Dhe u kalua në punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 16-të e KKSBB-së

Lidhur me këtë pikë, kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli , pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin.

Megjë diskutime nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesi i KKSBB-së vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KKSBB-ja unanimisht, aprovi ekstraktin nga mbledhja e 16-të e KKSBB-së

Shtesë: Ekstrakti.

II

Diskutimi dhe aprovimi i Raportit të punës së KKSBB për vitim 2020

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli, i dha fjalën koordinatorit të KKSBB-s,Haqif Rustemit, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti (informata) e punës së KKSBB-së për vitin 2020

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Bekim Krasniqi,ne si OJQ kemi qenë aktiv dhe ngritë disa herë shqetësimet tona gjatë vitit 2020 por edhe viteve të kaluara dhe nuk janë marrë parasysh por janë mbet vetëm në letër. KKSBB-ja duhet të përkrahet edhe nga Kuvendi dhe të ketë buxhet të veçantë pasi që sa do që të ketë propozime nëse nuk ka buxhet ato projekte nuk po mund te realizohen.

Do të ishte mirë të ketë një punëtori dy ditore me anëtarët e KKSBB-s dhe të diskutohet për planin e punës së KKSBB-s për vitin 2021.

Ka edhe një gabim teknik te raporti ku emri i OJQ është i shënuar gabim duhet të jetë YAHR.

Fauz Xhemajli,nga ky këshill kanë dal disa herë rekomandime e të cilat kanë gjete zgjidhje siç ka qenë rasti me vendosja e kamerave të varrezat ortodokse dhe në fshatin Grackë në bashkëpunim me OSBE-n,diskutimi rreth materialit në fabrike të metalacit në Janjevë;ankesa për zonat e minuara në Grackë e ku FSK-ja e konfirmoj se është zonë e pastër,e shumë rekomandime tjera.

Në takime të KKSBB-s kanë qenë prezent edhe nga DKA-ja edhe nga Zyra për Barazi gjinore dhe nga ZLK-ja.

Brahim Duriqi,ne si DKA kemi marrë pjesë në disa takime të KKSB-s dhe atë unë personalisht kam marrë pjesë në disa takime të KKSB-s dhe është e pa drejtë që të shënohet se nga DKA-ja askush nuk ka marrë pjesë në këto takime.

Hasan Luma,edhe ne si zyrë për barazi gjinore kemi marrë pjesë në takime të KKSB-së,në fillim të vitit kam marrë pjesë kolegëje ime, Gjystja,ndërsa në takime tjera unë. Dhe është e pa drejtë që të thuhet në raport se nuk kemi marrë pjesë në takime. Ky raport duhet të përmirësohet.

Fatmir Goliqi,edhe ne kemi marrë pjesë në takime të KKSB-s,edhe pse shefja e ZLK-s gjendet në pushim mjekësor por e ka zëvendësuar Zorani dhe sot unë, dhe nuk është në rregull të thuhet që nuk kanë marrë pjesë ZLK-ja në mbledhje të KKSB-s

Zaim Baftiu,edhe unë kam vërejtje pasi që nuk se di në bazë të çfarë kriteri është bërë vlerësimi se kemi qenë aktiv ose jo aktiv. Ne si BIK në Lipjan kemi marrë pjesë në të gjitha takimet e KKSB dhe kemi ngritë disa çështje në këto takime. Ne vazhdojmë me aktivitete tona thuaj se çdo ditë.

Haqif Rustemi, ne këtë raport dhe këto vlerësime i kemi bërë në bazë të ligjit dhe akteve tjera në fuqi.

Bekim Krasniqi, tri ditë para pandemisë unë në takim të KKSB pata ngritë shqetësimin rreth përhapjes së pandemisë covid-19 në Kosovë por nuk është marrë parasysh. Po ashtu pata kërku që të ketë një mbledhje urgjente të KKSB që të diskutohet rreth kësaj pandemie por prapë nuk mur përkrahje. Ne si OJQ, kemi qenë shumë aktiv dhe do të vazhdojmë të jemi aktiv.

Fauz Xhemajli duhet të ketë disa përmirësime ky raport.

Meqë diskutime nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesi i KKSB-së vuri në votim raportin me vërejtjet e propozuara dhe pas votimit konstatoi se KKSB-ja unanimisht, aprovoi Raportin e punës së KKSB për vitin 2020

III

Diskutimi,plotësimi dhe aprovimi i Planit të Punës së KKSB për vitin 2021.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli, i dha fjalën koordinatorit të KKSB-s, Haqif Rustemi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga plani i punës së KKSB për vitin 2021.

Bekim Krasniqi, unë edhe më herët propozova që të ketë një punëtori dy ditore dhe të diskutojmë rreth planit të punës së KKSB-së për vitin 2021.

Haqif Rustemi,unë sot i kam dorëzu propozimet e planit të punës në email adresën e Shaha Eminit por si duket nuk i paskan sjellë sektori i kuvendit materialin te anëtarët e KKSB-së.

Armend Bikliqi unë kam marrë pjesë në disa takime të KKSB-së në komuna të ndryshme,dhe aty i kanë dhanë secili propozimet e veta pastaj janë votu.

Zaim Baftiu,ne kemi shënu propozimet tona në planin të cilin na kanë dorëzu sektori i Kuvendit por ende nuk e kemi dorëzu, por do të dorëzojmë të gjitha propozimet.

Fauz Xhemajli,unë pajtohna që të ketë një punëtori dhe të diskutohet rreth planit të punës për vitin 2021 të KKSB-s

Meqë diskutime nuk pati rreth kësaj pike, u kalua në pikën në vazhdim.

IV

Raport për gjendjen e sigurisë në teritorin e komunës së Lipjanit (PK, DMSH).

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli, i dha fjalën rreshterit të Stacionit Policor në Lipjan, Valdet Morina, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti për gjendjen e sigurisë në teritorin e komunës së Lipjanit.

Fehmi Gajtani,ne si KLSP-në Janjevë vazhdojmë me aktivitetet e përditshme,ku si KLSP kemi diskutuar për disa çështje siç janë:

1. Vendosja e shenjave të Komunikacionit.
2. Çështja e qeneve endacak.
3. Vendosja e kamerave në vendet kryesore të Janjevës.

Ne në Janjevë vazhdojmë kemi bashkëpunim të mirë me policinë dhe institucionet tjera.

Nazim Gashi,uroj që të gjithë jeni mirë dhe po kaloni,po ashtu uroj që të kaloj pandemia covid 19.

Ne kohën e fundit jemi përballë me vërshimet e fundit ku pjesa lindore është e dëmtuar më shumë,kemi pas dëmtime në infrastrukturë,bujqësi dhe në ekonomi familjare.

I falënderoj zjarrfikësit për punën qe po e bëjnë dhe vazhdojnë ta bëjnë çdo ditë, po ashtu i falënderoj edhe FSK-n dhe Policinë për mbështetjen që na kanë ofruar. Ekipet në teren e kanë kryer punën e tyre i kanë bërë raporte mbi dëmet e shkaktuara nga vërshimet e të cilat janë dërguar në qeveri.

Haqif Rrustemi,sa i përket situatës me vërshimet janë formuar të gjitha komisionet nga ana e kryetarit të komunës siç janë komisioni për dëmet në ekonomi familjare,dëmet në infrastrukturë, dëmet në bujqësi dhe i kanë bërë raportet për dëmet e shkaktuara.

Raporti i është dorëzuar qeverisë në vlerë mbi 1 milion euro dëme nga vërshimet,dhe po presim që Qeveria të na përgjigjet.

V

Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i mbledhjes Fauz Xhemajli,tha se a ka dikush të ngris ndonjë çështje?

Sa i përket kërkesës për dërgimin e raportit në qeveri për dëmet e shkaktuara nga vërshimet,ne kemi dërguar shkresën në qeveri dhe qeveria ka nda një shumë prej 70 mijë euro.

Fauz Xhemajli,po dalim me një rekomandim,vendosja e kamerave në vendet kryesore të Janjevës

Meqë diskutime tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i mbledhjes
Fauz Xhemajli